




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

<b>PËR / ZA / TO</b>	<b>Blerta Deliu, Kryetare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit për ankesa të mediave</b>	<b>DATE DATUM DATE</b>	<b>09.01.2024</b>
		Reference	....
<b>NGA / OD / FROM</b>	<b>Arben Loshi,</b>  Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës		
<b>SUBJEKTI PREDMET SUBJECT</b>	<b>Përgjigje në kërkesën për opinion ligjor adresuar nga komisioni Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për Anëtar të bordit për Ankesa të mediave</b>		

*E nderuar*

Bazuar në kërkesën tuaj si Kryetare e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit për ankesa të mediave, se a duhet të shpallet konkurs për dy (2) pozita, apo me tre (3) kandidatë komisioni mund të mbajë intervistimin për plotësimin e vetëm një pozite, ndërsa për pozitën e dytë, meqë nuk ka kundër kandidatë të shpallët konkursi, bashkëngjitur mund të gjeni përgjigjen në Kërkesë, të përgatitur nga Drejtoria për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit.

Me respekt,



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština – Assembly*

<b>PËR:</b>	<b>Z. Arben Loshi,</b> Zëvendësues i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës	<b>Datë</b>	<b>3 janar 2024</b>
		<b>Referencë</b>	<b>-01</b>
<b>PËRMES:</b>	<b>z. Xheladin Hoxha</b> Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme për shërbime legislative		
<b>NGA:</b>	<b>Znj. Zoja OSMANI,</b> Drejtoresh e Drejtorisë për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit		
<b>SUBJEKTI:</b>	<b>Opinion ligjor në lidhje me përzgjedhjen e kandidatëve për anëtar të Bordit për ankesa të mediave</b>		

**I. HYRJE**

Drejtorja për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit ka pranuar një kërkesë për të ofruar një opinion ligjor nga zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Arben Loshi.

Kërkesa me numër reference, MK-ad hoc-01, datë 29.11.2023, është adresuar nga, znj. Blerta Deliu-Kodra, Kryetare e Komisionit Ad-hoc, për përzgjedhjen e kandidatëve për Anëtarë të bordit për ankesa të mediave (tani e tutje komisioni).

*Në kërkesën e saj për opinion, thuhet se "Komisioni Ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave, në mbledhjen e mbajtur me 29.11.2023, ka diskutuar në lidhje me listën e kandidatëve për Anëtarë të bordit për ankesa të mediave, për të cilat kishin aplikuar 4 kandidatë, mirëpo një prej tyre është tërhequr nga procesi,*

*respektivisht ka hequr dorë nga kandidimi i tij për të qenë anëtar i këtij bordi.”*

Si rezultat i kësaj, komisioni i venë para dileme se si duhet të vazhdohet tutje, ka kërkuar një opinion nga organet profesionale të Kuvendit, respektivisht kjo kërkesë i është referuar Drejtorisë për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit, se nëse:

- *“Duhet të shpallet konkurs për dy(2) pozita, apo me tre(3) kandidatë komisioni mund të mbajë intervistimin për plotësimin e vetëm një pozite, ndërsa për pozitën e dytë, meqë nuk ka kunderkandidatë të shpallët konkursi?”*

## **II. BAZA LIGJORE**

Duke analizuar objektin e kërkesës për dhënie të mendimit, Drejtoria për Shërbime juridike dhe përafrim të legjislacionit ka konsultuar legjislacionin përkatës në fuqi, si: Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës,<sup>1</sup> Ligjin nr. 04/L-044, për Komisionin e pavarur të mediave si dhe vendimin e Kuvendit të Kosovës për formimin e Komisionit Ad-hoc:

- *Ligji nr. 04/L-044, për Komisionin e pavarur të mediave, respektivisht, neni 38-Zgjedhja e anëtarëve të bordit për Ankesa”, në mënyrë shprehimore parasheh zgjedhjen e anëtarëve të Bordit për Ankesa, ku nën-paragrafi 2.3. i këtij neni parasheh se komisioni përkatës parlamentar, pas intervistimit rekomandon dy (2) kandidatë për çdo pozitë të anëtarit të Bordit për Ankesa, për të cilët konsideron që janë më të përshtatshëm, në bazë të kompetencave, përgatitjes profesionale, integritetit dhe përkushtimit të tyre. Nën-paragrafi vijues i po këtij neni, 2.4. parasheh hapat vijues ku Kuvendi zgjedhë njërin nga kandidatët e rekomanduar me shumicën e votave të deputetëve të Kuvendit që janë të pranishëm dhe që votojnë*
- *Rregullorja e Kuvendit të Kosovës, respektivisht nenet 44 dhe 45 parashohin aspektin e formimit të një komisioni parlamentar për çështje të ndryshme, siç kemi rastin me këtë komision Ad-hoc, si dhe*
- *Vendimin e Kuvendit të Kosovës, nr. 08-V-643, për formimin e Komisionit Ad-hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave, përmes së cilit, ky komision ”ad-hoc”, në bazë të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, bënë përzgjedhjen e kandidatëve për dy (2) anëtarë të Bordit për Ankesa të Mediave.*

---

<sup>1</sup> Rregullorja e Kuvendit të Republikës së Kosovës, 2022, e qasshme në këtë link: <https://gzk.rksgov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=61266&fbclid=IwAR2pkg1WSEcTI3ZFBsgCbPz0Vh5lt7ysr9nvzgMndq-6nYhvjljBQF00qKQ>

### III. ANALIZA

Drejtoria për shërbime Juridike dhe përafrim të legjislacionit ka analizuar bazën ligjore që rregullon këtë aspekt dhe ka arritur këtë:

### IV. PËRFUNDIM

- Komisioni Ad-hoc, për zbatimin e Vendimit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, nr. 08-V-643-datë 9 nëntor 2023, në bazë të Ligjit nr. 04/L-044 për Komisionin e Pavarur të Mediave, për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, për seancë plenare duhet t'i rekomandon katër (4) kandidatë.
- Duke marrë parasysh bazën ligjore të referuar me lartë, rezulton se për rastin konkret për dy (2) pozita kanë aplikuar vetëm 4 kandidatë, prej tyre një është tërhequr nga procesi, rrjedhimisht në mungesë të numrit të nevojshëm të kandidatëve për përzgjedhje (*duhet te këtë me shumë se 4 kandidatë*), komisioni Ad-hoc parlamentar nuk mund të zbatojë pikën II. të vendimit të Kuvendit.
- Andaj, për zbatim të vendimit të Kuvendit, për zgjedhjen e dy (2) anëtarëve të Bordit për Ankesa të Mediave, mungon numri i nevojshëm i kandidatëve për përzgjedhje.

**Shënim:** *Opinionin i dhënë nga Drejtoria për Shërbime Juridike dhe Përafrim të Legjislacionit përkitazi me këto çështje nuk ka fuqi detyruese, por ka për qëllim sqarimin e dispozitave të legjislacionit.*

Për me tepër, rreth udhëzimeve tutje, ju lutëm t'i referoheni këshillave që mund të ofrohen nga stafi profesional përkatës për mbështetjen e këtij komisioni Ad-hoc parlamentar.